VENDIM
Nr. 204, datë 12.12.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA SHPK, NR. 258, SERIA T14, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 133, DATË 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/1 prot., datë 2.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 172, datë 7.11.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë Energia gas and Power Albania sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/48 prot., datë 7.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria Energia Gas and Power Albania sh.p.k..
- Me shkresën nr. 461/2 prot., datë 12.11.2019, ERE-ja iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 461/3 prot., datë 19.11.2019, shoqëria Energia Gas and Power Albania sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e munguar, i cili është pasqyruar në pjesët takuese të saj.
- Shoqëria Energia Gas And Power Albania sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Në datën 11.6.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri aksionare (sh.a.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, me numër identifikimi (NUIS) L41811003F.
- Shoqëria Energia Gas And Power Albania sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 258, seria T14 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 133, datë 24.12.2014, me afat 5-vjeçar, kjo licencë përfundon në datën 24.12.2019.
- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria Energia Gas And Power Albania sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë Energia Gas And Power Albania sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë Energia Gas And Power Albania sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 258, seria T14, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 133, datë 24.12.2014, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.12.2019.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim, në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti